FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.196 dhjetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.226, datë 15.12.2008	Për ringritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për kodin zgjedhor, për shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr.5960, datë 2.12.2008 "Për kthimin e ligjit nr.10 019, datë 18.11.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"" ……..	10693
Vendim i KM nr.1619, datë 2.7.2008	Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore ……	10693
Vendim i KM nr.1620, datë 26.11.2008	Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna ……	10701
Vendim i KM nr.1627, datë 17.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktor …….……	10711
Vendim i KM nr.1628, datë 17.12.2008	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve ……	10711
Vendim i KM nr.1630, datë 17.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurën e prokurimit, të kryer nga këshilli i qarkut të Elbasanit, si autoritet kontraktor ……	10712
Vendim i KM nr.1661, datë 29.12.2008	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor …….	10713
Udhëzim i MASH nr.38, datë 3.11.2008	Për administrimin e kuotave për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008-2009, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë…….	10718

Udhëzim i MASH nr.40, datë 22.11.2008	Për plotësimin e kuotave të parealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008 – 2009 ……	10719
Udhëzim i MASH nr.41, datë 4.12.2008	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, në institucionet publike te arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009 ……	10721
Udhëzim i MASH nr.42, datë 9.12.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të parealizuara në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009 …….	10723
Udhëzim i MASH nr.43, datë 9.12.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të parealizuara në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në Akademinë e Arteve, në vitin akademik 2008 – 2009 ……..	10724
Udhëzim i MPÇSSHB nr.2324, datë 5.12.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.203, datë 1.2.2007 në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit" …….	10726
Vendim i KMBSH nr.84, datë 11.12.2008	Për miratimin e përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë ……	10727
Vendim i ERE nr.135, datë 18.12.2008	Për një devijim nga rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s në lidhje me shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a. ……	10727
Vendim i ERE nr.136, datë 18.12.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike ……	10728
Vendim i ERE nr.137, datë 18.12.2008	Për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë "Antea Cement" sh.a., për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës Krujë ……	10729
Vendim i ERE nr.138, datë 22.12.2008	Për një ndryshim në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.40, datë 31.8.2005, të ndryshuar …….	10730
Vendim i ERE nr.139, datë 22.12.2008	Për një ndryshim në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.41, datë 31.8.2005, të ndryshuar …	10731
Vendim i ERE nr.140, datë 22.12.2008	Për miratimin e disa ndryshimeve në "Modelin e tregut të energjisë elektrike", që do t'i propozohen për miratim Këshillit të Ministrave	10732

VENDIM
Nr.226, datë 15.12.2008

PËR RINGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR KODIN ZGJEDHOR, PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR.5960, DATË 2.12.2008 "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR.10 019, DATË 18.11.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 86 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ringrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar.

II. Komisioni ka për detyrë shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr.5960, datë 2.12.2008 "Për kthimin e ligjit nr.10 019, datë 18.11.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"".

III. Përbërja e Komisionit, anëtarët, vlefshmëria e mbledhjeve, vendimmarrja dhe grupi i ekspertëve teknikë mbeten sipas vendimit të Kuvendit nr.192, datë 30.6.2008, të ndryshuar.

IV. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.1619, datë 2.7.2008

PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të neneve 24, 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nivelet e pagave për funksionarët e zgjedhur të organeve, përfaqësuese dhe ekzekutive, të njësive të qeverisjes vendore janë:

a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari	134 000 - 170 000 lekë;
- Nënkryetari	127 000 - 134 000 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me mbi 100 000 banorë:

- Kryetari	90 000 - 134 000 lekë;

- Nënkryetari 60 000 - 90 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 50 001-100 000 banorë:

- Kryetari 60 000 – 115 000 lekë;
- Nënkryetari 49 000 – 90 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001- 50 000 banorë

- Kryetari 49 000 – 90 000 lekë;
- Nënkryetari 39 000 – 75 000 lekë

d) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001- 20 000 banorë

- Kryetari 39 000 – 75 000 lekë;
- Nënkryetari 26 000 – 66 000 lekë.

dh) Për njësitë e qeverisjes vendore me nën 5 000 banorë:

- Kryetari 35 000 – 52 000 lekë;
- Nënkryetari 25 000 – 40 000 lekë.

e) Për këshillin e qarkut:

- Kryetari 87 000 – 130 000 lekë;
- Nënkryetari 57 000 – 90 000 lekë.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të bashkive të tjera, të njësive bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë të këshillit të qarkut janë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Paga e grupit (kolona 2) - Diploma e shkollës së lartë- është 11 000 lekë në muaj.

Paga e grupit (kolona 2)

- Për nëpunësit, që kanë kryer vitet e plota të studimit të shkollës së lartë, e vërtetuar kjo me librezën e notave, por që nuk kanë mundur të mbrojnë diplomën - të jetë 9 000 lekë.

6. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

7. Funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civilë/nëpunësit në administratën e organeve ekzekutive dhe të njësive të qeverisjes vendore përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, të përcaktuara në lidhjen nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Kjo shtesë jepet në kushtet e përputhjes së fushës së kualifikimit, gradës apo titullit shkencor, me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në njësitë e qeverisjes vendore.

b) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin/funksionin e tij, sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ai do të përfitojë vetëm shtesën e përcaktuar për pozicion/funksion.

c) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin/funksionin e tij, sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ai do ta përfitojë shtesën, në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin, që ka.

ç) Në çdo rast sa më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor, sipas shkronjave "a", "b" e "c" të kësaj pike dhe jo shumën e tyre.

Për aplikimin e kësaj shtese zbatohen rregullat e udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

8. Shtesa për pozicion është, përkatësisht, sipas kolonës 5, të lidhjes nr.1 për Bashkinë e Tiranës, sipas kolonës 5 të lidhjes nr.3, për këshillin e qarkut, dhe sipas kolonave 3, 4, 5, 6 e 7 të lidhjes nr.2, për bashkitë e tjera, komunat dhe njësitë bashkiake të Tiranës.

9. "Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit" apo "Drejtorët" në institucionet e përcaktuara në

pikën 1, të këtij vendimi, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike vendore, dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsim të lartë në degët "Inxhinieri elektronike" a "Informatikë", përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese do të bëhet, rast pas rasti, nga drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

10. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase bëhet në përputhje me lidhjen nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Për emërtesën "Sekretar", niveli i pagës do të jetë:

- Sekretar i kryetarit të Bashkisë së Tiranës IV-a (Lidhja nr.1);
- Sekretar i kryetarit të bashkive të tjera IV-b (Lidhja nr.2);
- Sekretar i kryetarit të këshillit të qarkut të Tiranës IV-b (Lidhja nr.3).

12. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme janë:

- Drejtori i kabinetit në Bashkinë e Tiranës dhe sekretari i këshillit bashkiak të Tiranës - Kategoria II-a (Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
- Këshilltari i kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zëdhënësi -Kategoria II-b (Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
- Drejtori i kabinetit dhe sekretari i këshillit të qarkut, - Kategoria I-b, (Lidhja nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
- Këshilltari i kryetarit të këshillit të qarkut dhe zëdhënësi -Kategoria II-b (Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
- Drejtori i kabinetit dhe sekretari i këshillit bashkiak për bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe komunat - Kategoria I-b (Lidhja nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
- Këshilltari i kryetarit të bashkisë dhe zëdhënësi për bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe komunat - Kategoria II-b (Lidhja nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi).

13. Kufijtë e pagave për punonjësit e policive bashkiake dhe të komunave, janë sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë e këshilli i komunës miratojnë pagën për secilin funksion, të zgjedhur apo të emëruar, brenda kufijve të pagave të përcaktuara, përkatësisht në lidhjet nr.1, 2, 3 e 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Këshilli i Bashkisë së Tiranës miraton pagën për funksionarët, e zgjedhur apo të emëruar, të njësive bashkiake të Tiranës.

15. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore, kur është e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet, që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njësimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar.

16. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës, përkatësisht, të kryetarit të këshillit të qarkut, kryetarit të bashkisë, të njësisë bashkiake dhe të komunës.

17. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe, në mbështetje të akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi, për pagat e punonjësve të ndërmarrjeve ekonomike.

18. Pagat e nëpunësve, që punojnë në pozicione të shërbimit civil, por që nuk kanë arsimin e lartë, caktohen nga këshillat përkatës, në kufirin maksimal, deri në 30 000 lekë në muaj.

19. Pagat e punonjësve mbështetës të njësive të qeverisjes vendore të jenë në kufijtë nga 17 000 deri në 28 000 lekë në muaj.

20. Caktimi i grupit të qeverisjes vendore, për efekt page, bëhet nga prefekti, në bazë të numrit të banorëve të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, në fillim të çdo viti.

21. Vendimi nr.551, datë 7.11.2002 i Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", të ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

		PAGA MUJORE (LEKË)			
KLASA	**KATEGORITË**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA E POZICIONIT**
	1	**2**	**3**	**4**	**5**
		Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	11 000	2%		Nga 66.000 deri 114.000
II	II-a	11 000	2%		Nga 63.000 deri 103.500
	II-b	11 000	2%		Nga 55.000 deri 86.500
III	III-a	11 000	2%		Nga 29.000 deri 68.500
	III-a/1	11 000	2%		Nga 25.000 deri 58.500
	III-b	11 000	2%		Nga 23.000 deri 51.500
IV	IV-a	11 000	2%		Nga 21.000 deri 39.000
	IV-b	11 000	2%		Nga 19.000 deri 29.000

Lidhja nr.2

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

		PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	**KATEGORITË**	**PAGA INDIVIDUALE**		**SHTESA E POZICIONIT**				
				Njësi të qeverisjes vendore me mbi 100.000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 50.001-100.000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 20.001-50.000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me 5001-20.000 banorë	Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë
	1		2	4	5	6	7	8
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi në punë	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	11.000	2%	Nga 22.000 deri 60.500	Nga 19.500 deri 55.000	Nga 18.000 deri 44.000	Nga 17.000 deri 30.000	Nga 14.500 deri 25.000
II	II-a	-	-		-	-	-	-
	II-b	11.000	2%	Nga 18.00 deri 48.500	Nga 17.000 deri 44.000	Nga 14.500 deri 34.000	Nga 13.500 deri 29.000	Nga 13.000 deri 22.500
III	III-a	-	-		-	-	-	-
	III-b	11.000	2%	Nga 17.000 deri 39.000	Nga 14.500 deri 35.700	Nga 13.500 deri 31.000	Nga 12.000 deri 24.200	Nga 11.000 deri 20.700
IV	IV-a	11.000	2%	Nga 10.500 deri 27.500	Nga 10.500 deri 25.500	Nga 9.500 deri 24.200	Nga 8.500 deri 23.000	Nga 8.000 deri 18.000
	IV-b	11.000	2%	Nga 9.500 deri 25.000	Nga 8.500 deri 22.000	Nga 8.000 deri 18.000	-	-

Shënim: Këshilli i bashkisë dhe komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin banorëve të regjistrit të gjendjes civile, në fillim të vitit kalendarik.

Lidhja nr.3

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

		PAGA MUJORE (LEKË)			
KLASA	**KATEGORITË**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA E POZICIONIT**
	1	**2**	**3**	**4**	**5**
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	11 000	2%	0	Nga 35.000 deri 68.500
II	II-a	-	-	-	-
	II-b	11 000	2%	-	Nga 23.000 deri 51.500
III	III-a	-	-	-	-
	III-/b	11 000	2%	0	Nga 17.000 deri 39.000
IV	IV-a	11 000	2%	0	Nga 10.500 deri 29.000
	IV-b	11 000	2%	0	Nga 9.500 deri 21.500

Lidhja nr. 4

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL, PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Vendet e punës në shërbimin civil grupohen në 4 klasa si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e programeve të përgjithshme në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre programeve të përgjithshme dhe përdorimin efiçent të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:
I-b Sekretar i Përgjithshëm (atje ku krijohet në bazë të strukturës)

Klasa II: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e programeve në fushën që mbulon dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:
II-a Drejtor i drejtorisë së përgjithshme
II-b Drejtor drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja programore për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e programeve në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.
Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:
III-a Përgjegjës sektori, Kryeinspektor

III-a/1 Përgjegjës sektori në Bashkinë e Tiranës

III-b Specialist i nivelit të lartë
Inspektor

Klasa IV: Kjo klasë merret me zbatimin e programeve ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.
Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:
IV-a specialist i nivelit të mesëm
IV-b specialist

Lidhja nr.5

STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BASHKIVE E TË KOMUNAVE

Emërtesa	**Paga (lekë/muaj)**

	Nga	deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	70 000	79 000
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	55 000	60 000
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore me mbi 50000 banorë	35 000	40 000
Inspektor i Policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	30 000	35 000
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	40 000	45000
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e qeverisjes vendore, me mbi 50 000 banorë	30 000	35000
Punonjës i policisë në njësitë e qeverisjes vendore, nga 5001 deri në 50 000 banorë	28 000	33 000

Lidhja nr.6

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/ TITULLI SHKENCOR	SHTESA LEKË/MUAJ
Titullar i institucionit	Profesor	30.000
	Profesor i asociuar	25.000
Zëvendëstitullar i institucionit	Doktor i shkencave	20.000
Drejtor drejtorie Këshilltar	Doktor i shkencave	25.000
Përgjegjës/Shef sektori Specialist	Studime të thelluara Pasuniversitare/Master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë	20.000

Shënim. Vlerat 20.000 lekë, për diplomat "Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare" dhe 25.000 lekë, për gradën shkencore "Doktor i shkencave", aplikohen për nëpunësit/titullarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuara sipas listës që do t'i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.1620, datë 26.11.2008

PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË TROJEVE, QË NDODHEN NË TË GJITHA BASHKITË DHE NË DISA KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për

kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të trojeve urbane, brenda vijës së verdhë të të gjitha qyteteve, në të dymbëdhjetë qarqet, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Harta, ku janë të përcaktuara zonat e vlerësimit të tokës, do të shërbejnë ato, të miratuara me:

a) vendimin nr.555, datë 29.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës e të Dibrës, si dhe qytetet Bulqizë, Burrel, Klos dhe Vlorë";

b) vendimin nr.653, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Lezhës, Dibrës, Korçës dhe Kukësit";

c) vendimin nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës".

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Drejtoria e Shitjes dhe Administrimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.555, DATË 29.8.2007

Qarku	**Bashkia**	**Lagjja / zona**	**Përshkrimi i zonave**	**DASHPP Vlera e Tregut lek/m²**
Berat	Berat	Z. I	Nga Kombinati deri tek Ura e Gorricës, lagjja "Barrikada", "Çlirimi", "Dëshmorët e Kombit", Muzakaj. Kufizohet nga fshatrat Starovë, Velabisht	3.100

	Berat	Z. 2	Nga Ura e Gorricës deri te hotel turizmi: Lagjet “Gorricë”, “Mangalem”, “Kala”, “13 Shtatori”, “22 Tetori”, “28 Nëntori”, “10 Korriku”, “30 Vjetori”	5.200
	Berat	Z. 3	Nga gjykata e rrethit deri në kufi të zonës “2”: Lagjet “Jani Vruho”, “Donika Kastrioti”, “Kushtrimi”.	4.400
	Berat	Z.4	Përgjatë rrugës Berat-Skrapar, përfshin pjesërisht pjeshkoren dhe lagjen Uznovë	3.300
	Ura Vajgurore			2.100
	Kuçovë	Z. 1	Nga Dl 4 deri te stacioni i autobusit Berat-Kuçovë: lagjet:11 Shkurti”, “11 Janari”, “Tafil Skëndo”	1.800
	Kuçovë	Z. 2	Nga stacioni i autobusit Berat-Kuçovë deri te aksi rrugor “1 Maji”: lagjet “Llukan Prifti”, “Meteori”, “Perondi”	2.200
	Çorovodë			700
	Poliçan			450
Dibër	Bulqizë		Përfshin ndërmarrjen gjeologjike, ndërtesat e minierës, ish-parku i mallrave. Në kufi me fshatin Vajkal.	
	Burrel	Drita	Kryqëzimi i rrugës së spitalit me bulevardin kryesor, unaza e vjetër, stadiumi	
	Burrel	Partizani	Kryqëzimi i rrugës së spitalit me bulevardin kryesor, unaza e vogël e qytetit deri në fshatin Komsi	
	Burrel	Pjetër Budi	Lulishtja, shtëpia e kulturës, turizmi. Në kufi me fshatrat Batër dhe Komsi	
	Klos			
Gjirokastër	Gjirokastër	Z. 1	Fshati Mashkullorë, zona 2, stadiumi në lagjen “18 Shtatori”, fshati fusha Valare	10.000
	Gjirokastër	Z. 2	Kufizohet me kodrën e Shtufit, zonën 4, lagjja “Granicë e Sipërme, Sheshi i Çerçizit, rruga e lagjes “11 Janari”, rruga nacionale, fshati “Arshi Lengo” dhe Granicë e Sipërme	12.000
	Gjirokastër	Z. 3	Kodra e Shtufit, lagjet Granicë e Sipërme, “18 Shtatori”, fshati Mashkullorë	8.000
	Gjirokastër	Z. 4	Lagjet “18 Shtatori”, Manalat, Clake, Dunavat, lagjja Punëtore, Zinxhirat dhe pjesë të fshatit Mashkullorë dhe “Arshi Lengo”	6.000
	Gjirokastër	Z. 5	Lagjja “11 Janari”, Cfake, Palorto dhe pjesë të fshatit “Arshi Lengo”	6.000
	Gjirokastë	Z. 6	Lagjja Palorto dhe Varosh, lagjja Punëtore, zona industriale, SMT, fshati Kordhoc.	7.000
	Gjirokastër	Z. 7	Rruga nacionale, lagjja Manalat, Cfake, Dunavat, territore të fshatrave Lazarat dhe “Arshi Lengo”	3.000
	Libohovë		Brenda vijës së verdhë të qytetit Libohovë kufizuar me fshatrat Labovë, Nepravishtë, Bulo dhe Hilomo.	400
	Tepelenë	Z. 1	Pjesa e qytetit që kufizohet me zonën industriale, komuna Qendër-Tepelenë me fshatrat Luzat, Beçisht dhe Bënçë.	1.000
	Tepelenë	Z. 2	Pjesa e qytetit që kufizohet me qytetin e vjetër, komuna Qendër-Tepelenë me fshatrat Mamaj, Veliqot, Becisht dhe Bënçë.	150
	Memaliaj		Lumi Vjosë, fshati Memali, Vasjar.	400
	Përmet	Z. 1	Pjesa e qytetit që kufizohet me komunën Qendër-Përmet dhe Petran, me fshatrat Kutal, Bodar, Leshicë, Gilarisht	700
	Përmet	Z. 2	Pjesa e qytetit që kufizohet me komunën Piskovë dhe Petran, me fshatrat Bual, Bodar, Leshicë, Qilarisht	500
	Përmet	Z. 3	Pjesa e qytetit që kufizohet me komunën Piskovë dhe Petran, me fshatrat Bual, Leshicë	550
	Këlcyrë		Brenda vijës së verdhë të qytetit Këlcyrë kufizuar me fshatrat Beduqar, Dhiar, Dishnicë, Varibob, Riban, Mezhgoran, Peshtan, Katundishtë	200
	Vlorë	1 Maji-Qeriba Derri	Rrugët “P. Rexhepi”, e “Paqes”. Shkolla “Jani Minga” dhe “Marigo Pozjo”	10.000
	Vlorë	24 Maji	Lagjja “11 Janari”, fshati Nartë, rruga Vlorë-parku	10.000

			industrial, zgjatim i rrugës nr.1, zona industriale e vjetër dhe e re (TEC), fusha e vjetër e aviacionit.	
Vlorë	Vlorë	10 Korriku	Rruga "Pelivan Leskaj", kanali V.B., rruga e Centrales (te shkolla e Marinës), fshati Kaninë, hotel "Bologna", zona Qendër - Skelë, hotel "Internacional"	12.000
	Vlorë	Pavarësia	Rruga nr.1 e shkollës "Industriale", "Pelivan Leskaj", kanali U.B., rruga e "Skelës", "Transballkanike". stadiumi "Flamurtari", universiteti "Ismail Qemali", Pallati i Kulturës, porti i Vlorës	14.000
	Vlorë	Uji Ftohtë	Rruga e "Centrales", fshati Rradhimë, fshati Kaninë. shkolla e Marinës, shkolla Tregtare, rezidencat qeveritare	15.000
	Vlorë	Isa Boletini	Rruga e "Centrales", "Vlorë-Skelë", e "Shkollës Industriale". kinoteatri "Petro Marko", shkolla "Ismail Qemali", "Muç Delo"	12.000
	Vlorë	Lef Sallata Rilindja	Rruga nr.4, nr.l, "Vlorë-Skelë", "Transballkanike". gjykata e apelit, shkolla "24 Maji"	12.000
	Vlorë	28 Nëntori	Pjesa midis serave, rruga "Ismail Qemali", ish-fusha e aviacionit, rruga e shkollës së Muzikës. godina qendrore e P.T., monumenti i "Pavarësisë", ish-hotel "Adriatik", Xhamia e Plumbit, Kisha Katolike	12.000
	Vlorë	Dëshmorët	Rruga e shkollës së Muzikës, rruga nr.4, rruga "Vlorë-Skelë", "Transballkanike". Shkolla e Muzikës "Naim Frashëri", shkolla "24 Maji", Kisha Ortodokse.	12.000
	Vlorë	Hajro Çakërri	Rruga "Vlorë-Skelë", "Ismail Qemali", "Perlat Rexhepi", e "Centrales", fshati Kaninë. gjykata e rrethit Vlorë, Varrezat e Dëshmorëve, Xhamia e Kuqe, Teaja e Kuzbabasë.	11,000
	Vlorë	Osman Haxhiu	Rruga pas bashkisë, "Perlat Rexhepi", sheshi i bashkisë. sahati i vjetër dhe qendra e vjetër e qytetit.	10,000
	Vlorë	15 Tetori	Rruga "Ali Demi", sheshi i bashkisë, fshati Bestrovë, Babicë e Xhuherinë, bashkia e qyetit dhe Këshilli i qarkut.	10,000
	Vlorë	Kushtrimi	Rruga Vlorë-Fier, Vlorë-Nartë, "Dëshmorët", ish-fusha e aviacionit, rruga "P. Malile". Dega e rendit dhe burgu i ri, parku i autobusëve.	10,000
	Vlorë	Partizani	Rruga "Ali Demi", "Selam Musai", fshati Xuherinë, Babicë dhe Serishtë, sheshi i bashkisë dhe rruga "Ali Demi", spitali.	9,000
	Vlorë	Lirimi	Rruga pas bashkisë. shkolla "Rilindja", sheshi në hyrje të qytetit.	9,000
	Vlorë	Jali-Nartë	Fshati Nartë-Bestrovë, rruga e zonës industriale. Depozitat e naftës dhe gazit, ndërmarrja e fidanishtes.	10,000
	Vlorë	4 Heronjtë	Rruga "Selam Musai", fshati Serishtë, rruga mbi "Varrezat e Dëshmorëve". Shkolla "4 Heronjtë".	10,000
Dibër	Peshkopi	Naim Çaushi	Nga kryqëzimi i bulevardit "Elez Isufi" me "Nazmi Rushiti" deri te frigoriferi. Ish-NTA dhe shkollën e mesme pedagogjike	11,000
	Peshkopi	Gjok Doçi	Nga kryqëzimi i bulevardit "Elez Isufi" me "Nazmi Rushiti" deri te ish-magazinat e tregtisë	10,000
	Peshkopi	Aksion	Nga kryqëzimi i bulevardit "Elez Isufi" me rrugën e "Kamenit" deri në kufi me fshatrat Tomin, Staravec dhe prefekturën.	7,500
	Peshkopi	Treg	Nga kryqëzimi i bulevardit "Elez Isufi" me rrugën e "Kamenit" deri në n/centralin elektrik. Në kufi me fshatin Staravec, rrugën e llixhave	9,500
	Peshkopi	Vehbi Dibra	Nga agjencia e biletave në Dobrovë, rrugën e fshatit Begjunec, përroi i Peshkopisë	8,000
	Peshkopi	SMT	Nga kryqëzimi i bulevardit "Elez Isufi" me rrugën e fshatrave Polozhan, Tomin, Ushtelencë. Ka në brendësi	5,000

			ish-ndërmarrjen SMT. Në kufi me rrugën nacionale të fshatit Muhurr	
Korçë	Korçë	Z.1	Rrugët "Nuci Gogo", "Lefter Serafini", shëtitorja "Fan Noli", bulevardi "Gjergj Kastrioti", rrugët "Midhi Kostani". Përfshihen godina e prefekturës, Katedrala, Pallati i Kulturës, hotel turizmi, banka kombëtare, teatri "Andon Z.Çajupi"	27,000
	Korçë	Z.2	Rrugët "1 Maji", "Kiço Grexho", trikotazhi, rrugët "28 Nëntori", "6 Dëshmorët", "Emin Duraku", "Bajram Curri". Përfshihen bashkia, prokuroria, gjykata dhe radio Korça	24,500
	Korçë	Z.3	Rruga "Niko Kovaçi", stadiumi, rrugët "1 Maji", "Llazi Opari", "Luan Shkëmbi", "Skënder Çaçi". Përfshihen xhamia, pazari i vjetër, fabrika e miellit etj.	20,000
	Korçë	Z.4	Rrugët "Konferenca e Labinotit", "Rexhep Telhai", unaza e qytetit, rrugët "Fan Noli", "Emin Duraku", "Xhaferr C.Lubonja". Përfshihen varrezat e francezëve, spitali, gjykata e apelit, ndërmarrja e ujërave dhe rrugëve.	14,500
	Korçë	Z.5	Lumi i Barçit, unaza e qytetit, kodrat Partizani, rruga "Kolli Tupa". Përfshihen parku rinia, parku i mallrave, trikotazhi, SMT, fabrika e tullave, varrezat e Shën Triadhës.	10,000
	Pogradec	Z.1	Kufizohet me fshatrat Symiz, Maliq, Kolanec, Libonik dhe lumi Devoll	16,500
	Pogradec	Z.2	Pjesa e qytetit ku ndodhen bashkia, spitali, pallati i kulturës	11,000
	Pogradec	Z.3	Përfshihet pjesa tjetër e qytetit e kufizuar me ish-NB dhe fshatin Taç	5,000
	Bilisht	Z.1	Përfshin territorin në hyrje të qytetit deri në rrugën "1 Maji" ku ndodhen shkolla e mesme, bashkia, pallati i kulturës.	2,500
	Bilisht	Z.2	Përfshin territorin e fabrikës së verës dhe fushën e sportit	2,800
	Maliq		Rruga e Hoçishtit, shkolla e mesme, ndërmarrja e grumbullimit, reparti ushtarak, shtëpia e oficerëve	1,900
	Ersekë	Z.1	Kufizohet me rrugën e Vishovicës, fshati Bitinckë, Bilisht dhe lumi Devoll	850
	Ersekë	Z.2	Kalaja e qytetit, rruga "Kajo Karafili", liqeni i Ohrit, fshatrat Vërdovë dhe Buçimas. Përfshihet hotel turizmi, bashkia, stadiumi, gjykata, prokuroria	650
	Leskovik	Z.1	Kalaja e qytetit, rruga "Kajo Karafili", fshati Vërdovë, unaza e qytetit. Përfshihet spitali i qytetit	1,400
	Leskovik	Z.2	Rruga e Mokrës, fshati Vërdovë, Kurora e Gështenjave dhe unaza e qytetit. Përfshihen varrezat publike.	1,750
Kukës	Kukës	Lagja 1	Varrezat e qytetit, pjerrësit e liqenit, rruga Kukës-Morinë, "Hoxhë Mehmeti", obelisku "Lidhja e Prizrenit", Fakulteti Ekonomik, artizanati, rruga "Lugu i Prizrenit", kufizohet me fshatrat Bozhe dhe Kodër Lumë	2,000
	Kukës	Lagja 2	Ndërmarrja gjeologjike, rrugët "Kosova", "Ejup Topojani", agjencia e udhëtarëve, rruga "Islam Spahiu", 6 kt, rruga "Dituria".	3,500
	Kukës	Lagja 3	Rruga "Islam Spahiu", 6 kt, rruga "Mahmut Daci", ndërmarrja ujësjellësi, rruga "Hasan Gërxhalliu", komisariati, rruga "Sul Elezi" dhe fshati Bicaj	4,000
	Kukës	Lagja 4	Shtëpia e oficerëve, rrugët "Drini", "Dituria", radio Kukësi, rruga e gjykatës dhe xhamisë	4,500
	Kukës	Lagja 5	Gjykata, prefektura, rruga "Ramazan Zaskoci", turizmi i ri, spitali, karburanti dhe "Varrezat e Dëshmorëve".	5,000
	Kukës	Lagja 6	Rrugët "Drini", shtëpia e oficerëve, rruga "Sul Elezi", komisariati, rruga "18 nëntori"	5,500
	Krumë	Lagja 1		1,500

	Krumë	Lagja 2		1,200
	Bajram Curri	28 gushti		2,500
	Bajram Curri	Dardania		2,500
	Bajram Curri	Partizani		1,500
Lezhë	Lezhë	Besëlidhja	Lagje kryesore e qytetit Lezhë me shtrirje nga ish-banka e shtetit. Përfshin qendrën e qytetit, hotel Lis deri te lagje Gurra. Kjo lagje së bashku me lagjen Gurra përfshijnë zonën me ndërtimet më të larta në Lezhë me komplekset e banimit 8-12 kate ku disa kanë edhe kate nëntokësore	20,000
	Lezhë	Gurra	Lagje kryesore e qytetit Lezhë në vazhdim të lagjes Besëlidhja. Shtrihet mbi Varrezat e Dëshmorëve. Kufizohet në anën lindore me lagjen e spitalit dhe atë Varosh. Në jug dhe juglindje kufizohet me komunën Kolsh	17,000
	Lezhë	Skënderbeg	Në veri të lagjes Besëlidhja. Përfshihen sheshi qendror i qytetit, prefektura, bashkia dhe institucione të tjera. Kryesisht është zonë arkeologjike e qytetit; përfshihen vendvarrimi i Skënderbeut. Shtrihet në veri deri tek ish-ndërmarrja Ushqimore Lezhë. Kufizohet në anën veriore të Kalasë me lagjen Varosh.	18,000
	Lezhë	Spitalit-Varosh	Përfshihet zona kodrinore e qytetit Lezhë. Përfshihen spitali rajonal, dhe zona arkeologjike përreth. Kufizohet në anën lindore me komunën Kolsh	17,000
	Lezhë	Kodër Marlekaj	Lagje me ndërtesat pa leje, por të përfshira në zonën informale për legalizim. Kufizohet në anën lindore me lagjen Besëlidhja dhe Skënderbeu, në veri me komunën Balldre, në veri perëndim, perëndim dhe jug me komunën Shëngjin, fshatrat Ishull Shëngjin, Ishull Lezhë etj.	16,500
	Rrëshen		Qyteti Rrëshen është pa ndarjet e tjera administrative	2,800
	Rubik		Lagjja nga hyrja e qytetit deri tek ana perëndimore e lumit Fan dhe ish-uzina e bakrit	2,180
	Laç		Qyteti Laç është pa ndarjet e tjera administrative. Përfshin 6 lagje edhe zonën industriale ku përfshihet fabrika e superfosfatit	1,870
	Mamurras		Në aksin e rrugës së vjetër Lezhë Tiranë. Në zhvillim në të dyja anët e rrugës Mamurras autostradë	1,510
Shkodër	Durrës	Z.1	Rruga "Andon Naçi", "Skënderbej", "Rrethimi i Portit Detar, Ale.....	22,000
	Durrës	Z.2	Brryli i Currilave, Vila e Zogut, depo e ujit, rruga e "Arbërve", "Jon Buzhiqi", "Hajdar Demiri", Porti Detar, rruga "Aleksandër Goga" rruga tregtare, Shëtitorja "Taulantia"	24,000
	Durrës	Z.3	Rruga "Kristaq Sotiri", "Andon Naçi", "J.Ballhysa", stacioni i trenit, unaza e re, rruga "Aleksandër Goga"	18,000
	Durrës	Z.4	Vija kufizuese e zgjeruar, brryli, currilat, Vila e Zogut, depo e ujit, bregu i detit deri në Bisht të Pallës	7,200
	Durrës	Z.5	Unaza e re, rruga "Telat Noga" bashkohet me rrugën e Porto Romanes	5,400
	Durrës	Z.6	Hyrja e Durrësit nga ura e dajlanit, autostrada Durrës-Tiranë, rruga Shkozet-Shënavlash (ish-këneta e Durrësit)	3,600
	Durrës	Z.7	Porti Detar, Përroi i Agait, rruga e Plazhit, vija bregdetare	30,000
		Z.7/1	Zonë plazhi-Brezi I deri 200 m	
	Durrës	Z.8	Linja hekurudhore, mbikalimi plepa, rruga e plazhit	12,000
	Durrës	Z.9	Trekëndëshi hekurudhor Durrës-Tiranë-Kavajë. Territore të komunës Rrashbull	8,400
	Durrës	Z.10	Linja hekurudhore, deri te rruga e vjetër Durrës-Tiranë. Autostrada Durrës-Tiranë, ura e Dajlanit deri në rrugën e Shënavlashit	10,800
	Manëz			1,325

	Sukth	Z.1	Qendra Sukth i Ri	2,000
	Sukth	Z.2	Sektori Rrushkull	1,500
	Sukth	Z.3	Sektori Vadardhë	800
	Sukth	Z.4	Sektori Kullë	1,300
	Sukth	Z.5	Sektori Hamallaj	600
	Sukth	Zona zhvillimi	Zona e zhvillimit industrial sipas investimeve; brezi 200 m nga rruga nacionale	7,800
	Shijak	Z.1	Lagjja Erzen	6,100
	Shijak	Z.2	Lagjja Kodër	12,200
	Shijak	Z.3	Lagjja Popullore	11,600
	Krujë	Z.1	Lagjja nr.1	5,300
	Krujë	Z.2	Lagjja nr.2	3,900
	Krujë	Z.3	Lagjja nr.3	8,700
	Krujë	Z.4	Lagjja nr.4	2,100
	Fushë-Krujë	Z.1		1,100
	Fushë-Krujë	Z.2		5,100
	Fushë-Krujë	Z.3		4,100
	Fushë-Krujë	Z.4		4,100
Elbasan	Elbasan	11 Nëntori	Rrugët nr.22, “28 Nëntori”, “Ismail Zyma”, konvikti i universitetit	16,500
	Elbasan	28 Nëntori	Lumi i Zaranikës, rruga “17 Marsi”. Autostrada Elbasan-Metalurgjik, rrugët “11 Nëntori”, “Jani Kilica”	17,500
	Elbasan	5 Maji	Rrugët “Emin Haxhiademi”, nr.22, “Shën Thanasi”, “Koço Brisku”, Rruga Nacionale Tiranë-Pogradec.	13,000
	Elbasan	Aqif Pasha		18,500
	Elbasan	B Dardha		18,000
	Elbasan	Çlirimi		12,500
	Elbasan	Emin Matraxhiu		10,000
	Elbasan	Haxhias	Unaza e jashtme e qytetit, përroi i Namazgjasë, rruga “Kamber Sejdini”, “Borodin Mitarja”	9,000
	Elbasan	Hekurudha	Ullishtja e Elbasanit, rrugët “Hysen Palluqi”, “Shën Thanasi”, “Ismail Zyma”. universiteti i Elbasanit, Spitalet e Qytetit	7,000
	Elbasan	Kala		20,000
	Elbasan	Kongresi Manastirit	Kalaja e qytetit	19,500
	Elbasan	Partizani		14,500
	Elbasan	Qemal Stafa		18,500
	Elbasan	S.Dylgjeri	Lumi i Zaranikës, Ullishta e Elbasanit, rrugët “Ismail Zyma”, “Mehmet karadaku”, “Janaq Kilica”, “Dyl Haxhire”	17,500
	Elbasan	Sul Papri		16,500
	Elbasan	Shënkolli		7,000
	Elbasan	Skëndërbej		9,000
	Elbasan	Visarion Xhuvani	Lumi Shkumbin, unaza e re e qytetit, varrezat e qytetit	18,000
	Elbasan	Brigada 17 Sulmuese	Autostrada Elbasan –Metalurgjik, lumi Shkumbin	15,000
	Elbasan	Luigj Gurakuqi	Rruga e re, shkolla 9-vjeçare “Visarion Xhuvani”	18,000
	Peqin			1,600
	Gramsh	Sporti, Holta		2,000
	Gramsh	Ish Pam		450
	Cërrik			2,200
	Librazhd			10,500
	Prrenjas			2,800
	Belsh			1,950
Fier	Fier	Z.1	Rruga “Mujo Ulqinaku”, “Jakov Xoxa”, fshatrat Drizë,	24,500

			Zhupan, rrugët "Ramiz Aranitasi", "Aulona", hekurudha, bashkia, prefektura, stadiumi, banka dhe posta	
	Fier	Z.2	Rruga "Jani Bakalli", fshatrat: Drizë, Portëz, Sheq, rrugët "Aulona", "Ramiz Aranitasi, spitali, Kisha dhe Instituti i Naftës	16,000
	Fier	Z.3	Fshati Mbrostar, rrugët "Mujo Ulqinaku", fshati Sheq, rruga "Kastriot Muça", hekurudha	12,000
	Fier	Z.4	Fshatrat Mbrostar, Vajkan, rruga Fier-Seman, hekurudha, komuna Qendër	9,000
	Fier	Z.5	Rruga Fier-Seman, fshatrat Drizë, Zhupan, hekurudha, fshati Afrim dhe komuna Qendër	8,000
	Patos	Z.1	Fshatrat Dukas, Margellicë, zona industriale, bashkia, stadiumi, ndërmarrja e gazit	3,500
	Patos	Z.2	Fshatrat Banaj, Dukas, Grizë dhe Petrovë. Biblioteka dhe kinoteatri	2,500
	Patos	M.Matohiti		500
	Roskovec			2,500
	Lushnje	Z.1	Stacioni i trenit, rruga e fabrikës së miellit, hekurudha, bashkia, nënprefektura, muzeu	19,000
	Lushnje	Z.2	Fshatrat Kasharaj, Karbunar, spitali, stadiumi	13,000
	Lushnje	Z.3	Fshatrat Karbunar, Savër	9,000
	Lushnje	Z.4	Fshatrat Alprenaj, Hajdaraj, prokuroria, gjykata, komisariati i policisë	8,000
	Ballsh	Z.1		
	Ballsh	Z.2		
	Divjakë			2,500
Shkodër	Shkodër	Z.1	Rruga "Zogu i Parë", Banja e vogël, kryqëzimi tek "Isa Boletini", kryqëzimi Serreq, Truma e Dugajve të Reja, universiteti, stadiumi, tregu i Zdrales, 5-kt me urë	24,000
	Shkodër	Z.2	Bahçallëk, Shirokë, Zogaj, Pazari-Fusha e Draçinit, Qafë Hardhi, Arra e Madhe, Serreq, Kisha e Madhe, Fusha e Lëkurave, spitalet, uzina e telave, fermentimi, Rus, unaza e qytetit	15,000
	Shkodër	Z.3	Përfshin zonën tjetër deri në vijën e verdhë të qytetit të kufizuar me fshatrat Dobraç, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj, Berdic e Sipërme, Zues	8,500
	Vau i Dejës		Kufizohet me fshatrat Sheldi, Karm, Dush, Gomsiqe, Mjedë, Spatharë	1,800
	Pukë		Kufizohet me fshatrat Pukë, Lajthizë, Luf, Qerret	1,000
	Koplik		Kufizohet me fshatrat Pjetroshan, Koplik i Sipërm, Bogic-Palv	6,200
	Fushë Arrëz			
Tiranë			Grupimi I	
	Tiranë	11/3	Laprakë, dogana, spitali ushtarak, bregu i lumit, Fushë Mëzez, Don Bosko	20,473
	Tiranë	6	Shkolla Teknologjike, Kombinati, Vaqarr, Selitë, Yzberisht, Sharrë	20,717
	Tiranë	3/2	Porcelani, IKV, Kinostudio, rruga "Hoxha Tahsim", lana e vjetër, fshati Linzë.	21,593
	Tiranë	½	Poligrafiku, Shkoza, Autoktraktorët, fshati Shkozë, Lanabregas, Linzë, Sauk	22,996
	Tiranë	4/2	Allias, rruga "Njazi Meka", bregu i lumit, Alliasi i Ri, rruga "Myslym Keta", "5 Maji".	24,360
	Tiranë	4/1	Kompleksi i spitaleve, SHIK, oxhaku, Allias i Ri, fshati Tufinë	24,754
			Grupimi II	
	Tiranë	5/4	Hotel "Diplomat", blloku "Vasil Shanto", Selitë e vogël	25,189
	Tiranë	3/1	Xhamllëku, Profarma, rruga "Bardhyl", rruga "Kongresi i	25,478

			Manastirit", bulevardi "Zhan D'Ark"	
	Tiranë	8/3	Tregu Industrial, fabrika Ajka, uzina Dinamo, bregu i lumit	26,094
	Tiranë	9/3	Rruga "Don Bosko", Fabrika e Këpucëve, bregu i lumit, politeknikumi, rruga "Siri Kodra"	26,137
	Tiranë	7/3	NSHRAK, Parku i Ministrisë së Brendshme, Fabrika e Bukës	26,787
	Tiranë	2/5	Qyteti Studenti, fakulteti ekonomik, Varrezat e Dëshmorëve, Sauk, Selitë.	27,104
	Tiranë	11/2	Ferluti, ish-uzina Tirana, FIAT	27,981
	Tiranë	7/4	Unaza e re, fabrika e miellit, ish-fusha e aviacionit, Yzberish	28,659
	Tiranë	1/1	Kinema "Ali Demi", fusha e sportit, fshati Shkozë, depo e ujit	29,829
			Grupimi III	
	Tiranë	8/2	Medreseja, farmacia nr.10, tregu industrial	30,111
	Tiranë	5/3	Kopshti Botanik, rruga "Komuna e Parisit", "Liqeni Artificial"	31,848
	Tiranë	11/1	Zogu i Zi, ish-Shkolla e Partisë	34,628
			Grupimi IV	
	Tiranë	2/3	Ministria e Jashtme, ambulanca nr.1, Bërryli	37,607
	Tiranë	7/2	Blloku i ambasadave, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	37,615
	Tiranë	2/4	Shkolla e Baletit, Ambasada Amerikane	37.718
	Tiranë	8/1	Selvia, gjimnazi "Partizani", Tafajt	38,595
	Tiranë	10/3	Blloku i ambasadave, rruga e "Durrësit", prokuroria	39,533
	Tiranë	9/2	stacioni i trenit, arkiva, hipoteka, politeknikumi	39.613
			Grupimi V	
	Tiranë	9/1	Piazza, gazeta "Zëri i Popullit", gjimnazi "Sami Frashëri", stacioni i trenit	42,299
	Tiranë	7/1	Gjykata e rrethit, ish-ekspozita "Shqipëria Sot"	42,621
			Grupimi VI	
	Tiranë	Parku	Liqeni Artificial, rruga "Dora D'Istria", rruga e Elbasanit, Sauk, Selitë	120,000
	Tiranë	5/2	Stadiumi "Selman Stërmasi", Shushica, liqeni artificial	120,000
	Tiranë	2/2	Pazari i Ri, 9-katëshet, shkolla "Avni Rustemi"	120,000
	Tiranë	10/2	Rruga "Myslym Shyri", Drejtoria e Policisë, Kisha Katolike	120,000
	Tiranë	10/1	PTT, Telekomi, Lidhja e Shkrimtarëve	120,000
			Grupimi VI	
	Tiranë	2/1	Piramida, stadiumi "Qemal Stafa"	180,000
	Tiranë	5/1	Ish-Blloku, libri universitar, vodafone	180,000
	Vorë		Kufizohet me fshatrat Marikaj, Marqinet, Kodër Vorë, Razë	2,750
	Kamëz		Kufizohet me fshatrat Valias, laknas, Bathore, Frutikulturë	2,650
	Kavajë	Z.1	Përfshin lagjen 1, ish-fabrikën e letrës, kufizohet me fshatin Çetë	16,000
	Kavajë	Z.2	Përfshin lagjen 2, stacioni i trenit, fshati Rrakull	15,000
	Kavajë	Z.3	Përfshin lagjen 3, kufizuar nga lagjet 1-2-4-6.	18,000
	Kavajë	Z.4	Përfshin lagjen 4, kufizuar nga lagjet 1-3-5, fshatin Momël	21,500
	Kavajë	Z.5	Përfshin lagjen 5, kufizuar nga lagjet 3-4-6, fshatin Bukaq. Ndodhen objektet e fabrikës së qelqit, gozhdë-bulonave, vaj-konservave	14,800
	Kavajë	Z.6	Përfshin lagjen 6, kufizuar nga lagjet 2-3-5, fshati Synej	16,700
	Rrogozhinë			3,500
Vlorë	Sarandë	Z.1	Rruga e hyrjes në Sarandë, kanali i Çukës, kodra e Lëkurësit, deti Jon, hotel "Butrinti"	15,000
	Sarandë	Z.2	Lugu i Bardhë, deti, kurora e qytetit, zona e ish-parkut. Lagjet nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, qendra e qytetit	15,000
	Sarandë	Z.3	Fshati Nivicë, rruga e hyrjes në Sarandë, fshatrat Shelegar,	12,000

			Gjashtë dhe Metoq	
	Sarandë	Z.4	Zona e Marinës, ish-parku	12,000
	Orikum		Deti Adriatik, fshati Radhimë, fshati Dukat	14,000
	Konispol		Fshati Dishat dhe Verve, kufiri i Shtetit, fshatrat Çiflik dhe Shkallë	2,450
	Himarë		Fshati Vuno, deti Jon, Qeparo	3,200
	Delvinë		Fshatrat Kakodhiq, Kostar, Vllahat, Sirikat, Kapodhiq dhe Rusan	
	Selenicë		Kufiri i qarkut Vlorë, fshati Romës, Treblovë, Picar, Armen dhe Mesaruk	

Qarku	**Bashki/komuna**	**Fshati**	**Përshkrimi i zonave**	**DASHPP Vlera tregut lek/m^2**
Durrës	B.Manëz	Hamallaj	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	19,000
	B.Sukth	Rrushkull	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	19,000
	K.Ishëm			15,000
	K.Ishëm	Lalëz	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	19,000
	K.Ishëm	Draç	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	19,000
	K.Ishëm	Bizë	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	19,000
	K.Maminas			10,000
	K.Maminas	Aksi Tiranë-Durrës	Zonë e zhvillimit industrial.brezi 200 m nga rruga nacionale	12,000
	K.Rashbull			7,000
	K.Rashbull	Aksi Tiranë-Durrës	Zonë e zhvillimit industrial.brezi 200 m nga rruga nacionale	12,000
	K.Xhafzotaj			4,750
		Aksi Tiranë-Durrës	Zonë e zhvillimit industrial.brezi 200 m nga rruga nacionale	12,000
	K.Rashbull	Shkallnur	Zonë plazhi brezi deri 200 m nga bregu	18,500
	Gjepalaj			1,500
	Katund i Ri			2,500
	Bubq			1,600
	Nikël			5,500
	Thumanë			2,100
	Cudhi			1,750
Tiranë	K.Golem	Golem	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	12,000
	K.Golem	Kryemëdhej	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	12,000
	K.Golem	Qerret	Zonë plazhi brezi deri 200 nga bregu	12,000
	Paskuqan			3,750
	Pezë			3,500
	Ndroq			9,500
	Vaqar			12,000
	Kashar			11,000
	Bërxull			7,500
	Shëngjergj			3,000

	Baldushk			2,250
	Krrabë			1,600
	Bërzhitë			8,000
	Zall-Bastar			1,400
	Dajt			8,000
	Farkë			11,000
	Petrelë			6,250
	Prezë			4,000
	Zall-Herr			1,550

VENDIM
Nr.1627, datë 17.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t'i përfundojë, deri më 31 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për tenderin, me objekt "Blerje karburanti", me fondet buxhetore të shpenzimeve, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1628, datë 17.12.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të

pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2007	1.00;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet, që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2008 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.731, datë 7.11.2007 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1630, datë 17.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, TË KRYER NGA KËSHILLI I QARKUT TË ELBASANIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e këshillit të qarkut të Elbasanit ta shtyjë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 23.12.2008, për procedurën e prokurimit, për fondin 2 833 333 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë, të parashikuar në buxhetin e vitit 2008, për objektin "Hartimi i detyrës së projektimit dhe hartimi i planit të përgjithshëm rregullues të Fushë Studen, në komunën Steblevë, të qarkut të Elbasanit". Për këtë objekt vlera e paradhënies të jetë në masën 10 për qind.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe këshilli i qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1661, datë 29.12.2008

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, shkronja "c", dhe 26 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas shtojcave la dhe 1b, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Buxheti për shërbimet spitalore jepet me hollësi sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Një fond jo më i madh se 10 për qind i buxhetit vjetor, të planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga ISKSH-ja, për t'ua rishpërndarë spitaleve gjatë vitit, me vendim të këshillit administrativ të ISKSH-së.

3. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, përgjegjës për realizimin e prokurimeve publike të vetë spitalit.

4. Spitali organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në bazë të ligjeve në fuqi dhe të rregullores së funksionimit.

5. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet, për financimin e shërbimeve shëndetësore, të ofruara prej tyre, duke filluar nga data 1.1.2009.

6. Në kontratën dypalëshe, ndër të tjera, përcaktohen:

a) shërbimet e parashikuara për çdo spital;

b) mënyrat e mbajtjes së të dhënave dhe të raportimit;

c) mënyrat e pagesës së spitalit;

ç) metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve;

d) treguesit e cilësisë dhe të performancës;

dh) mënyrat e ushtrimit të kontrollit nga ISKSH-ja;

e) sistemi i referimit dhe mënyra e identifikimit të të siguruarve;

e) mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

7. Spitali e ushtron veprimtarinë, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, e cila ka të drejtë t'i rivlerësojë ato çdo vit.

8. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë. Spitalet mund të kryejnë investime nga burime të tjera.

9. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet totalisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, sipas udhëzimit të miratuar nga këshilli administrativ i ISKSH-së. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

10. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me ISKSH-në, sipas këtij vendimi, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

11. Spitali zbaton tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

12. Spitali zbaton sistemin e referimit, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

13. Ministria e Shëndetësisë ushtron kontroll në spital, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj, si dhe për buxhetin, që financon.

14. lnstituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ushtron kontroll në spitale, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

Dispozita kalimtare

15. Ngarkohet drejtori i spitalit, që, brenda datës 31.3.2009, të lidhë kontratat e punës me të gjithë punonjësit, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995, të ndryshuar.

16. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë që, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për shërbimin spitalor, të organizojë ngritjen e këshillave administrativë të autoriteteve spitalore publike të qarqeve, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

17. Spitalet dhe ISKSH-ja janë të detyruara të llogarisin koston e çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

18. Standardet e spitaleve dhe treguesit e cilësisë e të performancës miratohen nga Ministria e Shëndetësisë, brenda datës 31.7.2009.

19. Ministria e Shëndetësisë të përcaktojë protokollet e diagnozës dhe të trajtimit, për çdo shërbim, deri në datën 31.12.2009.

20. ISKSH-ja të përfundojë lidhjen e kontratave me çdo spital, brenda datës 30.3.2009.

21. Deri në hartimin e kostove të shërbimeve, ISKSH-ja të financojë shërbimet e kontraktuara, mbështetur në buxhetin historik.

Buxheti i kontraktuar i spitalit ka këto zëra shpenzimesh:

a) Paga dhe shpenzime të tjera, lidhur me pagën e personelit;

b) Kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

c) Mallra e shërbime të tjera.

Spitali mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuara nga ISKSH-ja.

22.Spitali mund të rishpërndajë buxhetin, duke zbatuar kufizimet e mëposhtme:

a) Rishpërndarja nga "Shpenzime për mallra e shërbime" te "Pagat" mund të bëhet vetëm brenda një kufiri prej 2%;

b) Rishpërndarja nga "Pagat" te "Shpenzimet për mallra e shërbime" është e mundur vetëm brenda një kufiri prej 5 %.

Të dy kufijtë llogariten, në bazë të buxhetit të kontraktuar. Rishpërndarja e burimeve bëhet me autorizimin e ISKSH-së.

23. Fondet për financimin e shërbimit spitalor, të papërdorura gjatë vitit buxhetor, trajtohen si të gjitha fondet e skemës së sigurimeve shëndetësore. Spitali mban në buxhetin e tij, për ta përdorur për vitin pasardhës, pjesën e papërdorur të buxhetit, të kontraktuar të vitit ushtrimor.

24. Numri total i punonjësve të spitaleve, për vitin 2009, të jetë i pandryshuar.

25. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën lb, të bëhet nga ISKSH-ja, vetëm kundrejt shtesave përkatëse të buxhetit, nga Ministria e Shëndetësisë.

26. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ISKSH-ja për të nxjerrë një udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

27. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

10713

Shtojca 1a

LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA ISKSH-JA

1. Shërbimi i kardiologjisë;
- hemodinamika;
- reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencës së sëmundjeve të brendshme;
10.Shërbimi i mjekësisë interne;
11.Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i ortopedisë;
15. Shërbimi i okulistikës;
16.Shërbimi i ORL-së;
17. Shërbimi i kirurgjise maksilo-faciale;
18.Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
19.Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20.Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
21.Shërbimi i urologjisë;
22.Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë dhe neurofiziologjisë;
24. Shërbimi i neurokirurgjisë;
25.Shërbimi i onkologjisë + kirurgjia onkologjike:
- statistika onkologjike (regjistri i kancerit);
- laboratori histopatologjik onkologjik;
- laboratori klinik-biokomik onkologjik.
26.Shërbimi rrezatim kobaltit;
27. Shërbimi infektiv;
28.Shërbimi i pediatrisë së përgjithshme:
- urgjenca pediatrike;
- fizioterapia pediatrike.
29.Shërbimi i pediatrisë së specialiteteve;
30.Shërbimi i pediatrisë infektive;
31.Shërbimi i kirurgjisë infantile;
32.Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
33.Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34.Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokomik, mikrobiologjikë, imunollogjikë, anatomopatologjikë, gjenetikë mjekësor, laboratori i mjekësisë nukleare);
35.Shërbimi i imazhërisë;
36.Shërbimi i fizioterapisë;
37.Shërbimi i statistikave;

38.Shërbimi i pneumologjisë;
39.Kirurgjisë torakale;
40.Shërbimi i ftiziatrisë;
41.Shërbimi i gjinekologjisë;
42.Shërbimi i obsetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës
44.Shërbimi i neonatologjisë;
45.Shërbimi i farmacisë;
46.Shërbimi i konsultave ambulatore;
47.Shërbimi i toksikologjisë;
48 Shërbimi i koordinimit të urgjencave;
49.Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
50.Kontrolli i infeksioneve spitalore.
Mbështetur në ligjin e spitaleve:
1. Spitali ditor
- shërbim të ndihmës së parë mjekësore për trajtim dhe kurim 24 orë.
2. Spitali në nivel bashkie (rrethi):
- Shërbim urgjence - shërbimi i mjekësisë së përgjithshme;
- Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
- Shërbimi i pediatrisë;
- Shërbimi i obsetrik-gjinekologjisë;
- Shërbimi i anestezi- reanimacionit;
- Shërbimi i radiologjisë;
- Shërbimi i laboratorëve klinik-biokimikë;
- Shërbimi i farmacisë.
3. Spitali në nivel qarku (rajonal)
- Shërbim urgjence;
- Shërbimi i mjekësisë së përgjithshme;
Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme + ortopedi traumatologji+urologji;
- Shërbimi i pediatrisë;
- Shërbimi i obsetrik-gjinekologjisë;
- Shërbimi i anestezi- reanimacionit;
- Shërbimi i radiologjisë;
- Shërbimi i fizioterapisë;
- Shërbimi i laboratorëve klinikë-biokimikë dhe mikrobiologjikë;
- Shërbimi i anatomisë dhe histologjisë patologjike;
- Shërbimi i hemodializës;
- Shërbimi i farmacisë.
Klinika e ORL-së
- Klinika e okulistikës;
- Klinika e sëmundjeve infektive;
- Klinika dermatotologjike;
- Kabineti i onkologjisë;
- Kabineti i riaftësimit;
- Kabineti i dietologjisë.

Shtojca 1b

LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA ISKSH

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;

6. Shërbimi kombëtar i transfuzionit;
7. Ofiçina elektro-mjekësore;
8. Njësia e transportit me helikopterë

Tabela 2

Nr	Institucioni dytësor	Buxhet 2009					
		Numri i personelit	Paga	Sigurime	Mallra e shërbime	Rezerve e pashpërndarë	Total
1	Berat	415	181,210	32,400	143,000		356,610
2	Bulqizë	108	49,280	8,800	24,000		82,080
3	Delvinë	32	14,550	2,600	6,500		23,650
4	Devoll	54	22,920	4,100	16,500		43,520
5	Diber	389	196,380	35,100	121,000		352,480
6	Elbasan	661	298,900	53,450	145,000		497,350
7	Fier	530	194,700	34,800	143,000		372,500
8	Gramsh	169	78,250	14,000	41,800		134,050
9	Gjirokastër	242	117,750	21,000	99,300		238,050
10	Has	43	18,550	3,300	13,400		35,250
11	Kavajë	170	78,150	14,000	33,000		125,150
12	Kolonjë	142	79,560	14,230	23,100		116,890
13	Korçë	609	354,000	63,300	198,000		615,300
14	Krujë	192	87,000	15,500	33,000		135,500
15	Kuçovë	78	37,050	6,600	12,600		56,250
16	Kukës	325	138,250	24,700	77,000		239,950
17	Laç	101	47,050	8,400	27,500		82,950
18	Lezhë	278	120,130	21,490	88,000		229,620
19	Librazhd	219	103,070	17,430	44,000		164,500
20	Lushnjë	315	147,700	26,420	93,500		267,620
21	Malësi e Madhe	17	7,070	1,265	6,000		14,335
22	Mallakastër	40	17,200	3,070	11,000		31,270
23	Mat	217	100,700	18,015	49,500		168,215
24	Mirditë	221	96,400	17,245	33,000		146,645
25	Peqin	30	13,350	2,390	11,000		26,740
26	Përmet	134	55,660	9,950	27,500		93,110
27	Pogradec	263	116,900	20,910	66,300		204,110
28	Pukë	167	91,200	16,315	40,500		148,015
29	Sarandë	202	110,750	19,810	48,700		179,260
30	Skrapar	146	58,850	10,530	19,800		89,180
31	Shkodër	807	363,500	65,020	198,000		626,520
32	Tepelenë	175	51,600	9,250	27,500		88,350
33	Q.S.U.T	2,685	1,268,000	226,500	2,350,000		3,844,500
34	Mat.nr.l	378	180,600	32,300	165,000		377,900
35	Mat.nr.2	280	136,150	24,350	121,000		281,500
36	Sanatoriumi	299	143,340	25,640	176,000		344,980
37	Tropojë	168	72,400	12,950	33,450		118,800
38	Vlorë	587	249,650	44,650	154,000		448,300
	Rezervë e pashpërndarë					500,000	500,000
	Totali	**11,888**	**5,497,770**	**981,780**	**4,921,450**	**500,000**	**11,901,000**

UDHËZIM
Nr.38, datë 3.11.2008

PËR ADMINISTRIMIN E KUOTAVE PËR SHTETASIT E HUAJ QË DO TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 1 ç dhe 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 2.7.2008 "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në IAL publike, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009"

UDHËZOJ:

1. Studentët që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, të përzgjidhen, për programet e studimit të kërkuara, në bazë të dosjeve të ardhura nga përfaqësitë diplomatike ose nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse.

2. Numri i kuotave të parealizuara për studentë që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe plotësohet nga shtetas të huaj që nuk vijnë në kuadër të këtyre marrëveshjeve.

3. Kjo kategori studentësh duhet të paraqesë në sektorin e marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për programin e studimit, në të cilin do të studiojë.

b) Formularin e aplikimit, të plotësuar.

c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit, të përkthyer dhe të legalizuar në gjuhën shqipe.

d) Fotokopje të njësuar të diplomës së shkollës së mesme, bashkë me vërtetimin nga Ministria e Arsimit dërguese se diploma është e vlefshme për të vazhduar studimet e larta.

e) Certifikatën mjekësore të përkthyer dhe të legalizuar.

f) Kopjen e lejeqendrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme.

4. Përzgjedhja e studentëve, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, të kryhet pasi të shqyrtohet nga Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe nga sektori i marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dokumentacioni i paraqitur nga këta shtetas të huaj.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë listën e studentëve të përzgjedhur sipas këtij udhëzimi, për t'u regjistruar në programet e studimit përkatës.

6. Ngarkohen Zëvendësministri i Arsimit të Lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, sektori i marrëdhënieve me jashtë, rektoratet e institucioneve publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.40, datë 22.11.2008

PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN AKADEMIK 2008 - 2009

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009"

UDHËZOJ:

1. Plotësimin e kuotave të parealizuara të pikës 1/a të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr.35, datë 17.10.2008.

2. Kuotat e parealizuara të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, të ndara ndërmjet këtyre institucioneve sipas programeve të ndryshme të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Agjencia e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL) të përgatisë formularin A4 me programet e studimit dhe kuotat përkatëse, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A4 të gjithë kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore 2008; dhe

b) nuk janë regjistruar në asnjë program studimi të ciklit të parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008-2009.

5. Formularët A4 të shpërndahen në DAR/ZA dhe në APRIAL.

6. DAR/ZA-të të tërheqin formularin A4, të personalizuar, APRIAL në datën 23 nëntor 2008.

7. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, që kanë plotësuar më parë formularin A3 dhe nuk janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë, të paraqiten në DAR/ZA në periudhën 24-28 nëntor 2008 për të tërhequr, plotësuar dhe dorëzuar formularin A4.

8. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, që nuk kanë aplikuar nëpërmjet formularit A3, të paraqiten në APRIAL në periudhën 24-28 nëntor 2008 për të tërhequr, plotësuar dhe dorëzuar formularin A4.

9. DAR/ZA-të sjellin në APRIAL formularët e plotësuar në datën 29 nëntor 2008.

10. Plotësimi i kuotave të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009 në Akademinë e Arteve të rregullohet me një udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

11. Ngarkohen për zbatimin të këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës për Arsimin e Lartë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, Agjencia e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

	Programi i studimit	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	Σ
1	Gjuhë-letërsi				49				49
2	Gazetari								0
3	Edukatë qytetare								0
4	Gjuhë angleze				59	67			126
5	Anglisht (Kukës)	16							16
6	Anglisht (Sarandë)	19							19
9	Frëngjisht			69			71		140
10	Italisht			14	55		51	70	190
11	Gjermanisht			69			69		138
12	Gjuhë-letërsi greke				70				70
13	Cikli i ulët			58	63	61		14	196
14	Cikli i ulët parashkollor			63	51	53	24	73	264
16	Fizkulturë						22		22
17	Matematikë						60	100	160
18	Fizikë						53		53
19	Matematikë-fizikë			100	79	56			235
20	Biologji-kimi				63		41		104
21	Matematikë-informatikë				100	82			182
22	Informatikë							100	100
23	Teknologji informacioni							100	100
24	Punë sociale								0
25	Infermieri e përgjithshme (Kukës)	41							41
26	Mami (Infermieri)					28	20		48
27	Turizëm				38	39			77
28	Marketing								0
30	Inxhinieri navigacioni							17	17
31	Inxhinieri mekanike							100	100
32	Menaxhim agrobiznesi (Lushnjë)		23			39			62
33	Financë-kontabilitet (Lushnjë)		13						13
34	Agromekanikë		19						19
35	Hortikulturë (Lushnjë)		24						24
36	Hortikulturë					55			55
37	Zootekni dhe biznes blegtoral		31						31
38	Vreshtari-enologji		32						32
39	Inxhinieri agronomike					50			50
	Gjithsej	76	142	373	519	530	411	574	2625

UDHËZIM
Nr.41, datë 4.12.2008

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11. 2008 "Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009",

UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme. Procesi të monitorohet nga administrata e Rektoratit dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijojnë programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme.

4. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore dhe të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

5. Në qoftë se kandidati fitues nuk ka dëftesë pjekurie origjinale, siç përcaktohet në pikën 4/a të udhëzimit, duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

6. Kandidatët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritë mësimore diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar) ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar e barasvlefshme me të.

7. Kandidatët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve në Tiranë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4 dhe 6 të këtij udhëzimi, duhet t'u nënshtrohen kritereve të veçanta (konkurseve të pranimit) të vendosura nga ky institucion për pranimet në studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe për programe të dyta studimi, të ngrihen komisione *ad-hoc*, me anëtarë të personelit akademik, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për këto programe, në përputhje me kuotat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008.

9. Institucionet publike të arsimit të lartë t'i shpallin dhe t'i afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të datës 15.12.2008, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës.

10. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme ku janë shpallur

fitues të zhvillohet nga data 15.12.2008 deri në datën 19.12.2008, prej orës 8.00 deri në orën 16.00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

11. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar në datën 22.12.2008.

12. Kuotat e pranimeve në studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, të përcaktuara në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

13. Regjistrimi i kandidatëve për transferim studimesh kryhet pas shpërndarjes nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, bazuar në pikën 5 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.37, datë 29.10.2008 "Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në vitin akademik 2008-2009".

14. Regjistrimi i kandidatëve të huaj, sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të listës së kandidatëve dhe shpërndarjes së kuotave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

15. Pas mbylljes së procesit të të gjitha regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare me regjistrimet e kryera brenda datës 30.12.2008 në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

16. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 5.12.2008, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme.

17. Këto njoftime të bëhen publike dhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin Lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.42, datë 9.12.2008

PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2008- 2009

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009",

UDHËZOJ:

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues në bazë të kuotave të përcaktuara në udhëzimin nr.40, datë 22.11.2008 "Për plotësimin e kuotave të parealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009".

2. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe për disa programe studimi edhe të rezultateve të konkursit, të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009".

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A4.

3. APRIAL përpunon të dhënat e marra nga formularët A4 dhe në datën 9.12.2008 shpall listën përfundimtare të kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A4, në përputhje me kuotat e përcaktuara në udhëzimin nr.40, datë 22.11.2008 dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 10.12.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

5. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë nga data 11.12.2008 deri në datën 16.12.2008. Për regjistrim, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet vetëm certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

6) Në rast se kandidatët fitues nuk kanë dëftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 5/a të mësipërme, të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë së lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

7. Sekretaria mësimore e pajis kandidatin që regjistrohet me një fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit, e vulosur.

8. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

9. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të

dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 18.12.2008.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë nga data 10.12.2008 t'i shpallin në vende të dukshme në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.43, datë 9.12.2008

PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, NË AKADEMINË E ARTEVE, NË VITIN AKADEMIK 2008 - 2009

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndrSyshuar dhe të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009",

UDHËZOJ:

1. Plotësimin e kuotave të parealizuara të pikës 1/a të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në Akademinë e Arteve sipas udhëzimit nr.35, datë 17.10.2008 "Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të rishpërndara për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008-2009".

2. Kuotat e parealizuara të pranimeve në Akademinë e Arteve, në vitin akademik 2008-2009, të ndara sipas programeve të ndryshme të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të maturës shtetërore të dhënë në vitet 2007 ose 2008 dhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, vitin akademik 2008-2009".

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve.

3. APRIAL në datën 9.12.2008 shpall listën e kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre, në përputhje me kuotat e përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 10.12.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listën përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në Akademinë e Arteve, e cila afishon menjëherë listën në vende të dukshme në mjediset e saj.

5. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarisë mësimore të Akademisë së Arteve nga data 12.12.2008 deri në datën 14.12.2008. Për regjistrim, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet vetëm certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

6. Në rast se kandidatët fitues nuk kanë deftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 5/a të mësipërme të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë së lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve.

7. Sekretaria mësimore e pajis kandidatin që regjistrohet me një fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit, e vulosur.

8. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve regjistron studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

9. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, Akademia e Arteve të dorëzojë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 19.12.2008.

10. Akademia e Arteve nga data 10.12.2008 të shpallë në vende të dukshme në mjediset e saj, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në këtë akademi.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga Akademia e Arteve.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, APRIAL dhe Akademia e Arteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

Tabela nr.1

Nr.	Programi i studimit	Kuota	Shuma
1	Kitarë	1	1
2	Klarinetë	1	1
3	Aktrim	4	4
4	Regji	3	3
5	Skenografi	2	2
6	Koreografi	2	2
7	Regji filmi	4	4
8	Skulpturë	2	2
9	Pikturë	1	1

		Gjithsej	20

UDHËZIM
Nr.2324, datë 5.12.2008

MBI NJË NDRYSHIM TË UDHËZIMIT NR.203, DATË 1.2.2007 NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.873, DATË 27.12.2006 "PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROGRAMEVE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E PAPUNË, QË KANË MBARUAR ARSIMIN E LARTË, BRENDA APO JASHTË VENDIT"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.203, datë 1.2.2007 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", bëhet ndryshim si më poshtë vijon:

Në nenin 1 togfjalëshi "datës 1 prill 2007" të zëvendësohet me togfjalëshin "çdo fillim viti".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
Anastas Duro

VENDIM
Nr.84, datë 11.12.2008

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT NGA BANKAT TË REZERVËS SË DETYRUAR NË LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, nenit 20, nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, pika 2 të rregullores "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", miratuar me vendimin nr.43, datë 16.7.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të lejojë bankat dhe degët e bankave të huaja të përdorin çdo ditë, deri në 40 (dyzet) për qind të shumës së rezervës së detyruar në lekë.

2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit

për publikimin menjëherë të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr.44, datë 16.7.2008 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 24.1.2009.

KRYETAR
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.135, datë 18.12.2008

PËR NJË DEVIJIM NGA RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S NË LIDHJE ME SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR LICENCIM TË SHOQËRISË "TERMOCENTRALI VLORË" SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 38 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a.,

dhe konstatoi:

- Nevojën për të filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit për licencim të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., pavarësisht mosparaqitjes së aplikimit sipas formatit të përcaktuar nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, duke vlerësuar se:
- Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a., është duke kryer një investim publik përmes ngritjes së një termocentrali në zonën e Vlorës.
- Ky investim shënon një nga investimet më të mëdha për sektorin elektroenergjetik i kryer me kontributin e përbashkët të Bankës Botërore, BERZH, BEI, marrëveshje këto të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.
- Duke filluar nga muaji shkurt 2009 do të kryhet testimi dhe komisionimi i termocentralit.
- Investimi pritet të përfundojë në maj të vitit 2009, kohë kjo që lidhet me fillimin e vënies në punë të termocentralit.

- Vënia në punë e termocentralit do të thotë që shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a., të fillojë të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" përcakton se ky aktivitet ushtrohet kundrejt licencimit nga ERE.
- Procedurat e licencimit nga ERE kërkojnë paraqitjen e tij sipas formatit të përcaktuar nga ERE para se Bordi i Komisionerëve të marrë vendim për fillimin e procedurave.
- Mosfillimi i procedurave të vononte procesin e licencimit duke konsideruar se kërkohet një afat prej 90 ditësh nga marrja e vendimit për fillim procedure deri në marrjen e vendimit për licencimin e një shoqërie,

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të kryejë një devijim nga neni 18 i rregullave të praktikës së procedurave të ERE-s, në lidhje me fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., pavarësisht mosplotësimit tërësisht të aplikimit sipas formatit të kërkuar nga ERE.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vënien në dijeni të aplikuesit për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.136, datë 18.12.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "TERMOCENTRALI VLORË" SHA PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa "a" dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10, pika 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe vendimit nr.135, datë 18.12.2008 "Për një devijim nga neni 18 i rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, në lidhje me fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a. dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Termocentrali Vlorë" sh.a., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a., të plotësojë dokumentacionin e munguar brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.137, datë 18.12.2008

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SHOQËRISË "ANTEA CEMENT" SHA PËR OBJEKTIN FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BURIZANËS KRUJË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 5, pika 3 të "Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Antea Cement" sh.a., për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar për objektin fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë,

konstatoi se:

Me vendimin nr.131, datë 2.12.2008, Bordi i Komisionerëve miratoi fillimin e procedurave për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë "Antea Cement" sh.a.

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe vendimit nr.77, datë 14.12.2007 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar",

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të klientit të kualifikuar shoqërisë "Antea Cement" sh.a., për objektin

fabrika e çimentos pranë Burizanës, Krujë.

2. Shoqëria "Antea Cement" sh.a., të njoftojë 90 ditë para bërjes efektive të statusit të klientit të kualifikuar ERE, OST sh.a. dhe KESH sh.a./furnizuesin publik me shumicë.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.138, datë 22.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.40, DATË 31.8.2005, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe neneve 7, 111, 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin për disa ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.40, datë 31.8.2005, dhe konstatoi nevojën për një ndryshim në kontratën e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve familjarë, duke qenë se paragrafi i fundit i pikës 8.1, germa "i" të kontratës së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve familjarë nuk plotëson më qëllimet e ligjit nr.9997, datë 22.9.2008 "Për disa ndryshime në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar", i cili nuk parashikon më vendosjen e masave administrative për mospërmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kontrata, sipas nenit 46/1 të këtij ligji,

VENDOSI:

1. Në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare, të miratuar me vendimin nr.40, datë 31.8.2005, bëhet ky ndryshim:

B) Në pikën 8.1, germa "i", paragrafi i fundit, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Në këto raste furnizuesi vepron sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. dhe KESH sh.a. për këtë vendim.

3. Ngarkohet furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.139, datë 22.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË JOFAMILJARE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.41, DATË 31.8.2005, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe neneve 7, 111, 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.41, datë 31.8.2005 dhe konstatoi nevojën për disa ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve jofamiljarë, duke qenë se paragrafi i fundit i pikës 8.1, germa "i" të kontratës së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve jofamiljarë nuk plotëson më qëllimet e ligjit nr.9997, datë 22.9.2008 "Për disa ndryshime në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar", i cili nuk parashikon më vendosjen e masave administrative për mospërmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kontrata, sipas nenit 46/1 të këtij ligji

VENDOSI:

1. Në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare, të miratuar me vendimin nr.41, datë 31.8.2005, bëhet ky ndryshim:

B) Në pikën 8.1, germa "i" paragrafi i fundit, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Në këto raste furnizuesi vepron sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. dhe KESH sh.a. për këtë vendim.

3. Ngarkohet furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.140, datë 22.12.2008

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË "MODELIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", QË DO T'I PROPOZOHEN PËR MIRATIM KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 53, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 22.12.2008, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për disa ndryshime në modelin e tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, dhe konstatoi nevojën e harmonizimit të këtij modeli tregu me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në "Modelin e tregut të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.339, datë 19.3.2008, të cilat do t'i propozohen për miratim Këshillit të Ministrave, me përmbajtjen si më poshtë:

A. Në pikën 4.2 paragrafi i katërt - Gjenerimi KESH Gen, hiqen fjalët "të tepërt" dhe kjo pikë bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

"Shet energji elektrike në tregun vendas ose atë të eksportit në përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE.".

B. Në paragrafin e fundit të pikës 4.13, germa "A", hiqen fjalët:

ose rregulla prokurimi.

C. Në pikën 5.7, shitjet e KESH Gen-it te blerës të tjerë, kudo ku përcaktohet: "KESH Gen mund të shesë energji elektrike të tepërt", të hiqen fjalët "e tepërt".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.1.2009
Doli nga shtypi më 7.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë